



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 82/6 prot.

Tiranë, më 11.01 2019

V E N D I M

Nr. 5 datë 11.01 2019

**"PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR.38
DATË 27.12.2018 "MBI MIRATIMIN E BURSIVE TË STUDENTËVE TË
VITIT TË DYTË DHE TË TRETË, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"**

Në zbatim të VKM nr. 784, dt. 26.12.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 903, dt. 21.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, shkresën e Degës së informacionit studentor dhe regjistrimeve nr.1841 datë 27.12.2019 "Dërgojmë informacion", shkresën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore nr. 55 datë 07.01.2019 "Përcjellja e studentëve me mesatare sipas VKM 9(nëntë) -10(dhjetë)", Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 11.01.2019

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve që do të përfitojnë bursë të plotë në vlerën 10000(dhjetëmijë)lekë në muaj, të pranuar në vitin e parë akademik në program studimi të ciklit të parë me notë mesatare vjetore mbi 9 (nëntë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë të përlogaritur si mesatare e të gjithë viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë rezultatet e maturës shtetërore. Lista e studentëve është sjellë nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, si më poshtë:

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes

E	A	Viti I	mesatare	9.18	bursë të plotë
L	M	Viti I	mesatare	9.06	bursë e plotë

2. Të miratojë listën e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve me mesatare të ponderuar mbi 9 që përfitojnë bursë të plotë në vlerën 10 000(dhjetëmijë)lekë në muaj, për vitin akademik 2018-2019, si më poshtë :

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes

NR.	EMER, MBIEMER	Viti	MES. PONDERUAR	Përfiton burse për vitin akademik 2018-2019
1	V. Z.	III	9.01	Bursë e plotë
2	O. R.	III	9.03	Bursë e plotë
3	R. N.	III	9.07	Bursë e plotë
4	A. D.	III	9.13	Bursë e plotë
5	X. M.	III	9	Bursë e plotë
6	D. C.	III	9.16	Bursë e plotë

3. Efektet financiare fillojnë nga fillimi i vitit akademik 2018-2019.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Dekanetet, Dega e Informacionit studentor dhe regjistrimeve, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Vladimir Cjonaaj

